

ARSYET E KTHIMIT TË LIGJIT NR. 44/2021
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996, “KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës **23 mars 2021**, ka miratuar ndër të tjera dhe ligjin **nr. 44/2021** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ky ligj me shkresën me nr. 927 prot., datë 01.04.2021 të Kuvendit, i është përcjellë Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje.

Sipas praktikës parlamentare rezulton se, edhe ky projektligj vetëm **formalisht** është paraqitur në Kuvend për shqyrtim në **datë 25 shkurt 2021**, sikur të ishte propozim i deputetit Alket Hyseni, ndërkohë që referuar akteve që shoqërojnë këtë nismë dhe që janë publikuar në faqen e Kuvendit, evidentohet se është pikërisht qeveria përmes Ministrisë së Drejtësisë ajo që ka hartuar ndryshimet ligjore, dhe jo deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Referuar Raportit të datës 19.03.2021, të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, që ka shqyrtuar këtë nismë, projektligji i propozuar për amendimin e Kodit të Procedurës Civile, referon se ka për qëllim:

- *rritjen e efencës dhe efektshmërisë në sistemin e drejtësisë nëpërmjet rregullimeve procedurale si ato për shqyrtimin e ankimeve lidhur me vendimet për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor;*
- *vendimet mbi kompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes;*
- *zhvillimin e proceseve gjyqësore në mënyrë efikase dhe sa më të shkurtër;*
- *shqyrtimin e rekurseve, gjykimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, procedimet paragjykimore, etj.*

Për këtë qëllim, ndërhyrjet konsistojnë në këto shtylla:

- *Ndryshimi i përbërjes së trupave gjykuese;*
- *Ndryshimet lidhur me çështjet që mund të shkojnë drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë;*
- *Kërkesat për përjashtimin e gjyqtarëve;*
- *Paditë me vlera të vogla;*
- *Ndryshimet në gjykimin në nivel apeli;*
- *Ndryshimi i procedurës së gjyimit në Gjykatën e Lartë.*

Sipas relacionit shoqërues të nismës së deputetit, relacion ky që rezulton i panënshkruar prej tij, evidentohet se *projektligji është hartuar nga një grup i posaçëm me përfaqësues nga institucionet*

e sistemit të drejtësisë (KLP, KLGJ, ILD, GJL, PP), nën kryesimin e Ministrisë së Drejtësisë, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e misionit të asistencës teknike Euralius.

Presidenti i Republikës vlerësoi përputhshmërinë e ligjit nr. 44/2021, dhe procedurës së ndjekur për miratimin e tij në raport jo vetëm me parashikimet e Kushtetutës, por edhe me pritshmëritë e qytetarëve të vendit dhe konstaton se, ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, **jo vetëm që janë miratuar përmes një procedure antikushtetuese dhe pa transparencë dhe konsultim gjithëpërfshirës, por këto ndryshime as nuk i japin zgjidhje përfundimtare problematikave të konstatuara sa i takon mbingarkesës së punës në gjykata dhe numrit të ulët të gjyqtarëve aktualisht në dispozicion, por ato mbulojnë në mënyrë të përkohshme defektet e zbatimit të ligjeve të miratuara në kuadër të Reformës në Sistemin e Drejtësisë, duke cenuar standartet për një sistem drejtësie profesional, eficient dhe të pavarur.**

Nëse ligji nr. 44/2021 do të hyjë në fuqi dhe do të zbatohet sipas përmbajtjes së miratuar ekziston rreziku që të cenohet automatikisht e drejta e qytetarëve, për t`u gjykuar nga një gjykatë e paanshme e objektive dhe që ka në përbërje të saj trupa gjyqësore, që përmbajnë jo vetëm numrin e nevojshëm të gjyqtarëve, por dhe plotësinë e aftësive profesionale, për të garantuar paanashmërinë në gjykim.

Nga shqyrtimi tërësor i praktikës parlamentare dhe përmbajtjes së ligjit nr. 44/2021, të miratuara në mungesë të një konsultimi gjithëpërfshirës, rezulton se ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile:

- Janë realizuar përmes një procedure që bie në kundërshtim flagrant me kërkesat e nenit 81, 83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese;
- Procedura e ndjekur nga Kuvendi i Shqipërisë për miratimin e këtij ligji cenon rëndë parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe ndarjes e balancimit të pushteteve;
- Procedura e ndjekur nga Kuvendi i Shqipërisë është realizuar në kushtet e urgjencës së pambështetur dhe të palegjitimuar, në më pak se 30 ditë nga dita e depozitimit në Kuvend (25 shkurt 2021), deri në miratimin e ligjit në datë 23 mars 2021;
- Ndryshimet ligjore janë realizuar në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë (nenet 26-28);
- Ndryshimet ligjore janë miratuar në mungesë të një procesi konsultimi publik gjithëpërfshirës, duke cenuar njëkohësisht edhe standardin e konsultimit publik të krijuar në miratimin e paketës ligjore në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë në vitin 2016-2017;
- Ndryshimet janë realizuar në mungesë të plotë të transparencës me publikun;
- Ndryshimet ligjore cenojnë rëndë klimën e besimit tek cilësia e paketës bazë të ndryshimeve ligjore të miratuara në vitin 2016, dhe tek implementimi i Reformës në Sistemin e Drejtësisë;
- Propozimi në realitet është produkt i punës së qeverisë dhe vullnetit të saj, ndërkohë që kamuflohet sikur të jetë propozim i një deputeti të Kuvendit;

- Ndryshimet ligjore shkelin dhe cenojnë, **parimin e sigurisë juridike; parimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit**; standardet për një **gjykim të drejtë** nga një **gjykatë e formuar me ligj**, përmes cenimit të përbërjes së trupave gjyqësore.

Për arsyet që do të parashtrihen në vijim, në bindje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ushtrim të së drejtës së parashikuar në pikën 1, të nenit 85 të saj, si President i Republikës kam vendosur që ligji nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, i duhet kthyer Kuvendit për rishqyrtim, për arsyet si më poshtë vijon.

* * * * *

I. Procedura e propozimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjit nr. 44/2021, bie ndesh me nenin 4, pikat 2 dhe 3, dhe 83, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

1. Nisma propozuese për këtë projektligj është ndërmarrë nga deputeti Alket Hyseni dhe është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në datën 25 shkurt 2021.

2. Pas depozitimit në Kuvend, ky projektligj, është shqyrtuar njëkohësisht dhe së bashku me një paketë tjetër prej **9 ligjesh** të tjera të rëndësishme, që kanë miratuar shumë ndryshime në legjislacionin bazë të sistemit të drejtësisë, ashtu si dhe në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, apo në ligjet organike të organizimit dhe të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, të institucioneve të reja të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e të policisë gjyqësore.

3. Konkretisht, në të njëjtën datë, në **23 mars 2021**, Kuvendi ka miratuar:

Ligji	Deputeti Propozues	Data e depozitimit të nismës	Data e shqyrtimit në Komisionin përgjegjës	Data e miratimit në Seancë Plenare
Ligj nr. 41/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;	Ulsi Manja	25.02.2021	19.03.2021	23.03.2021
Ligj nr. 42/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”	Adnor Shameti	25.02.2021	18.03.2021	23.03.2021

Ligj nr. 43/2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”	Adnor Shameti	25.02.2021	18.03.2021	23.03.2021
Ligj nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;	Alket Hyseni	25.02.2021	19.03.2021	23.03.2021
Ligj nr. 45/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”;	Klotilda Bushka	25.02.2021	18.03.2021	23.03.2021
Ligj nr. 46/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”	Klotilda Bushka	25.02.2021	18.03.2021	23.03.2021
Ligj nr. 47/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”	Ulsi Manja	25.02.2021	19.03.2021	23.03.2021
Ligj nr. 48/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”	Alket Hyseni	25.02.2021	18.03.2021	23.03.2021
Ligj nr. 49/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar”;	Vasilika Hysi	25.02.2021	18.03.2021	23.03.2021
Ligj nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”	Vasilika Hysi	25.02.2021	19.03.2021	23.03.2021

Pra, 10 projektligje që lidhen me themelin e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, çuditërisht:

- Janë hartuar nga një grup pune në Ministrinë e Drejtësisë;
- Mbrohen në Kuvend nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë;
- Janë depozituar në të njëjtën ditë, por nga deputetë, që po kaq çuditërisht kanë qënë në një linjë mendimi për ndryshimet, lidhur me mënyrën e re të organizimit të pushtetit gjyqësor?!
- Shqyrtohen brenda një dite, në datë **18**, ose **19 mars 2021** nga Komisioni përgjegjës për çështjet ligjore; dhe
- Miratohen në të njëjtën ditë në Seancën Plenare, në datë **23 mars 2021**.

Evidentimi i këtyre të dhënave si më sipër, na tregon qartë se nuk kemi të bëjmë me një rastësi, por me drafte të parapërgatitura nga ekzekutivi (qeveria), të formatuara sipas kërkesave të saj, që edhe pse kishte gjithë mundësitë t'i hartonte e propozonte vet këto propozime sipas procedurës që përcakton ligji, ka zgjedhur të përdorë deputetët e Kuvendit, për të realizuar nxitimthi qëllimet e saj.

Këshilli i Ministrave, ka zgjedhur rrugën e fiktivitetit të një praktike të tërë parlamentare, duke i depozituar këto projektligje me nënshkrime deputetësh, të cilët më pas i bie që të kenë aktruar, duke u sjellë si ideatorë të ndryshimeve ligjore, si njohës të thelluar të problematikës së fushës dhe që me “vullnet” po punojnë për reformën në drejtësi.

Është e natyrshme që duhet të njohësh mirë problematikën në një fushë të caktuar, që të jesh në gjendje të propozosh ndryshime ligjore për zgjidhjen e saj. Megjithatë, nga konsultimi i praktikave parlamentare për secilin nga 10 (dhjetë) ligjet e mësipërme të miratuara brenda një dite, administrata e Kuvendit është treguar e sinqertë, kur në disa prej raporteve të komisionit përgjegjës, ka pasqyruar realisht se, për disa prej nismave ligji në **komision mbrohet nga Ministria e Drejtësisë¹, duke anashkaluar tërësisht deputetin propozues që të vetmin kontribut kanë patur hedhjen e nënshkimit (firmës) për të shfrytëzuar të drejtën e propozimit.**

Edhe për këtë projektligj, në Raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të datës 19.03.2021, citohet shprehimisht se: **“Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishin të pranishëm nismëtari z. Alket Hyseni, Ministria e Drejtësisë znj. Etilda Gjonaj, drejtuesja e Misionit EURALIUS znj. Agnes Bernhard, këshilltarja ligjore rezidente në Departamentin e Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane (OPDAT) znj. Michelle Lacomy dhe këshilltari në Gjykatën e Lartë z. Miran Kopani.”**

Pra, për një nismë të deklaruar formalisht si e ndërmarrë nga një deputet, është ftuar për të dhënë shpjegime e për ta mbrojtur edhe ministrja e Drejtësisë.

4. Për më tepër, sipas praktikës parlamentare, projektligji është shqyrtuar në një mbledhje të vetme të Komisionit të Ligjeve të datës **19 mars 2021**, dhe më pas është përfshirë menjëherë për shqyrtim e miratim në seancën plenare të datës **23 mars 2021**.

¹ Për ilustrim, në Raportin e datës 18.03.2021, të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, për shqyrtimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 95/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", pjesë e paketës prej 10 ligjesh që prekin Reformën në Sistemin e Drejtësisë, citohet: **Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm dhe Znj. Etilda Gjonaj, Ministre e Drejtësisë, si dhe përfaqësues të misionit të EURALIUS në Shqipëri, Dr. Agnes Bernhard.** Për më shumë, konsulto praktikën e plotë parlamentare në link-un: <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/53574>.

Pra shqyrtimi nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në tërësinë e tij ka zgjatur vetëm një ditë (19.03.2021), dhe deri në seancën plenare që e ka miratuar ka kaluar një hark kohor prej 4 ditësh!

Ky fakt përbën shkelje të drejtpërdrejtë të neneve 81 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë, që do të sqarohet si më poshtë vijon.

4.1 Neni 4, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon:

“Neni 4

- 1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.*
- 2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.*
- 3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.”*

Përcaktimi i nenit të sipërpërmendur thekson se, Kushtetuta është ligji më i lartë dhe dispozitat e saj zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Ky parim kushtetues i sanksionuar në nenin 4, pika 3, **nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti.**

Përgjashtimi kushtetues, i parashikuar në këtë dispozitë, nënkupton se norma kushtetuese mund edhe të mos gjejë zbatim drejtpërsëdrejti, kur vet Kushtetuta ngarkon posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore/normative, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave.

Pra, Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke i vendosur kufij ligjvënësit për të vepruar në respekt të urdhërimeve kushtetuese, dhe me kujdesin maksimal sidomos në procesin legjislativ, të propozimit, shqyrtimit dhe miratimit të disa **ligjeve të rëndësishme, që përcaktohen në nenin 81, pika 2 dhe sipas procedurës së përcaktuar në nenin 83 të Kushtetutës.**

4.2 Në nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet shprehimisht se:

“Neni 81

- 1. Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.*
- 2. Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:**
 - a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta;*
 - b) ligji për shtetësinë;*
 - c) ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore;*
 - ç) ligji për referendumet;*
 - d) kodet;**
 - dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme;*

- e) ligji për statusin e funksionarëve publikë;
- ë) ligji për amnistinë;
- f) ligji për ndarjen administrative të Republikës.

4.3 Ndërkohë që në nenin 83 të Kushtetutës përcaktohet shprehimisht se:

“Neni 83

1. Projektligji votohet tri herë: në parim, nën për nen dhe në tërësi.
2. Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit.
3. *Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81 paragrafi 2, me përjashtim të nënparagrafit dh”.*

4.4 Në vetë Raportin e hartuar në datë 19 mars 2021, nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, citohet shprehimisht se: *“Fusha që rregullon ky projektligj përfshihet në shkronjën “d”, të pikës 2, të nenit 81, të Kushtetutës, sipas të cilës miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit kodet. Për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të miratimit me shumicë të cilësuar prej 3/5 (tre të pestat) e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”*

4.5 Referuar të dyja këtyre dispozitave kushtetuese, është e ndaluar që projektligje të kësaj natyre, siç është dhe **ligji nr. 44/2021**, përmes të cilit ndryshohet Kodi i Procedurës Civile, **të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar, dhe brenda 4 ditëve nga nisja e shqyrtimit në Komisionin përgjegjës!**

Në kundërshtim me kërkesat e Kushtetutës, shqyrtimi nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut deri në seancën plenare ka zgjatur vetëm një ditë (pra në datë 19 mars) dhe për një hark kohor prej vetëm 4 ditësh.

4.6 Shqyrtimi i këtij projektligji kaq të rëndësishëm është bërë brenda në një kohe rekord, **de facto me procedurë të përshpejtuar**, në shkëlqje të kërkesave të nenit 83, pika 3, të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit.

4.7 Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare të publikuar, **nuk rezulton që një e pesta e deputetëve t'i ketë kërkuar Kuvendit të Shqipërisë shqyrtimin e këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar** referuar nenit 83, pika 2 të Kushtetutës, ku citohet shprehimisht se:

- “2. Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit”.

4.8 Edhe sikur një gjë e tillë të kishte ndodhur, sërish shqyrtimi i këtij ligji me procedurë të përshpejtuar është i ndaluar nga neni 83, pika 3 i Kushtetutës, sepse projektligji *“Për disa shtesa*

dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, hyn në llojin e atyre akteve ligjore që kërkon shumicë të cilësuar për miratim, që parashikohen nga neni 81, paragrafi 2/d, i Kushtetutës, **shqyrtimi i të cilëve nuk mund të realizohet në asnjë rast me procedurë të përshpejtuar.**

4.9 Për më tepër, edhe Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, përveç kërkesave të tjera të detyrueshme për zbatim të parashikuar në nenet 26- 28, në pikën 5, të nenit 28 parashikon një rregull se:

*“5.Kuvendi **nuk mund të shqyrtojë** më shumë se tri projektligje me procedurë të përshpejtuar për programin 12-javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj për programin 3-javor të punës së tij”.*

Ndërkohë që siç rezulton dhe u pasqyrua në tabelën e mësipërme, Kuvendi brenda një dite në datë 23 mars 2021, faktikisht ka shqyrtuar në seancë plenare 10 ligje me procedurë të përshpejtuar, edhe pse shqyrtimi i këtyre ligjeve me procedurë të përshpejtuar është i ndaluar nga neni 83 pika 3 e Kushtetutës.

4.10 As në Raportin e Komisionit përgjegjës për çështjet ligjore, dhe as në ndonjë akt tjetër, nuk rezulton e arsyetuar se përse ky projektligj është përfshirë në procedura parlamentare në mënyrë të përshpejtuar, **në kundërshtim me kërkesat e nenit 83, pika 3, të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.**

4.11 Në lidhje me procedurën për shqyrtimin e kësaj nisme, që do të duhej të ndiqte një procedurë normale, Komisioni nuk argumenton asgjë në Raportin e tij, **duke e lënë këtë pjesë kaq të rëndësishme të zbatimit të urdhërimeve Kushtetuese, sikur të ishte një gjë e pavlerë.** Edhe sikur Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të argumentojë si mbrojtje faktin që nuk ishte ky organ që kërkoi apo e përfshiu ligjin nr. 44/2021 për shqyrtim në seancën plenare të datës 23 mars 2021, përsëri secili deputet anëtar i këtij komisioni kishte përgjegjësinë ta kundërshtonte këtë fakt, pasi të gjithë deputetët e këtij komisioni prezumohen si njohësit më të mirë të kërkesave kushtetuese. **Në rastin konkret, edhe pse deputetët e Komisionit të Ligjeve ishin në dijeni të shkeljes së rëndë të Kushtetutës që po kryhej, sërish ata me vullnet dhe me dashje kanë lejuar konsumimin e kësaj shkeljeje, duke votuar në seancë plenare ndryshimet e propozuara nga vet ata.**

Është e papranueshme që Komisioni i Ligjeve, si komision përgjegjës, të anashkalojë zbatimin e kërkesave të nenit 83, pika 3, dhe të Kushtetutës, në mënyrë kaq të lehtë, pa vlerësim, dhe duke e mos e trajtuar në Raportin e tij, **sikur një dispozitë kushtetuese në këtë drejtim të mos ekzistonte.**

Kushtetutëbërësi (qytetarët e Republikës së Shqipërisë) përmes neneve 81 dhe 83 të Kushtetutës, nuk kanë patur asnjë qëllim që të krijojnë ndonjë hapësirë për ligjvënësin, për të anashkaluar procedurën e miratimit të ligjeve kryesore të shtetit.

Por në kundërshtim me kërkesat e Kushtetutës, në të njëjtën ditë (datë 19.03.2021), Komisioni i Çështjeve Ligjore ka marrë në shqyrtim dhe ka miratuar për t'ia përcjellë seancës plenare, 4 (katër) ligje me rëndësi për sistemin e Drejtësisë, pa i kushtuar kësisoj, as kohën, dhe as vëmendjen e duhur këtyre projektligjeve, por i është bindur symbyllurazi vullnetit të qeverisë.

I vetmi përjashtim që bën Kushtetuta në nenin 83, pika 3, e saj, është mundësia që ka Kuvendi që në rast se gjendet në një situatë të nevojës ekstreme dhe urgjencës, nga ato ligje që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe që parashikohen në nenin 81 pika 2, të Kushtetutës, Kuvendi të mund të përdorë procedurën e përshpejtuar, **vetëm për shqyrtimin e ligjit për gjendjen e jashtëzakonshme (neni 83, pika 3, dhe neni 81, pika 2/dh).**

Ndërkohë që për ligjet e tjera të parashikuara në nenin 81, pika 2, Kuvendi i Shqipërisë, është i detyruar të zbatojë një procedurë normale, të marrë kohën e nevojshme pikërisht për shkak të natyrës dhe rëndësisë që paraqesin këto akte ligjore. Ndaj dhe kushtetutëbërësi, për ligje të veçanta, ka kufizuar kompetencat e Kuvendit duke përcaktuar një limit kohor brenda të cilit nuk duhet të ketë vendimmarrje, duke ndaluar drejtëpërdrejtë shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar.

Krahas rëndësisë që ka prezenca e deputetit dhe shprehja e vullnetit të tij, për të votuar një projektligj që miratohet përmes një shumice të cilësuar (tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij), Kushtetuta në nenet 81, pika 2, dhe 83, pikat 2 dhe 3, ka përcaktuar gjithashtu edhe detyrimin e ligjvënësit për të respektuar kriteret formale dhe materiale përgjatë procedurës ligjvënëse, duke ndaluar përdorimin e procedurës së përshpejtuar për miratimin e ligjeve të rëndësishme, siç janë Kodet.

Parashikimet e neneve 81, pika 2, dhe 82, pika 2 dhe 3, të Kushtetutës janë të një natyre shumë të rëndësishme, pasi në thelb ato veç të tjerave, synojnë mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, për shkak të rëndësisë që kanë fushat që rregullohen nga ligjet që miratohen me shumicë të cilësuar. Këto parashikime kushtetuese kanë për qëllim që t'i bëjnë këto ligje sa më të qëndrueshme, për të kërkuar gjithëmonë një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend, dhe jo vetëm, si dhe për të shmangur mundësinë që forca politike që ka shumicën, të mund të cenojë parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike. Edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka qenë shteruese në këtë drejtim ².

² Konsultohu me vendimet nr.25, datë 5.12.2008; nr.1, datë 12.01.2011, të Gjykatës Kushtetuese të RSH.

Respektimi i këtyre kritereve si formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, dhe procedurës së përcaktuar prej saj në procesin legjislativ, përbën një domosdoshmëri në shtetin e së drejtës. Nëse këto kritere që vendos Kushtetuta nuk respektohen, atëherë edhe parimi i shtetit të së drejtës konsiderohet thellësisht i cenuar.

Kuvendi ka miratuar brenda 4 ditëve, duke shmangur procedurën që kërkon Kushtetuta dhe vetë Rregullorja e Kuvendit, jo vetëm këtë ligj, por edhe 8 (tetë) ligjet e tjera që kërkojnë shumicë të cilësuar dhe që prekin sistemin e drejtësisë.

Kuvendi ka nisur shqyrtimin e projektligjit në datën 19.3.2021, në Komisionin përgjegjës për çështjet ligjore dhe e ka përfunduar procedurën parlamentare me miratimin në seancë plenare, në datën 23.03.2021, duke e realizuar shqyrtimin e nismës në total **brenda 4 ditëve, në kundërshtim flagrant me parashikimet e mësipërme kushtetuese.**

Në këto kushte, referuar sa më sipër, rezulton se Kuvendi i Shqipërisë, përveç qëllimeve të tjera, me miratimin e ligjit nr. 44/2021, ka shkelur përmbajtjen e dispozitave urdhëruese kushtetuese të nenit 4, 81, dhe 83, duke anashkaluar qartësisht zbatimin e tyre dhe duke cenuar shumë rëndë parimin e shtetit të së drejtës

* * * * *

II. Ligji nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, objekt shqyrtimi, është propozuar, prezantuar dhe shqyrtuar në kushte kur vullneti i organit ligjvënës provohet se ka qenë fiktiv dhe i paracaktuar/diktuar nga qeveria duke shkelur kështu parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve të parashikuar nga neni 7, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

1. Ligji nr. 44/2021, si propozim qeveritar i servitur vetëm formalisht nën propozimin e nënshkruar të një deputeti, **ka shmangur procesin e konsultimit gjithëpërfshirës.**

2. Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, rezulton se ky ligj **vetëm formalisht** është propozim i deputetit Alket Hyseni, me një shkresë përcjellëse pa numër protokolli, pa datë, me kokën e “Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste”, depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në datë **25.02.2021** (referuar vulës hyrëse që mban kjo shkresë përcjellëse), si dhe pa një relacion të nënshkruar nga deputeti propozues³.

³ Konsulto praktikën parlamentare të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit, në link-un: <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/53569>

3. Në Relacionin shoqërues të projektligjit citohet se: “Projektligji është hartuar një grup i posaçëm me përfaqësues nga institucionet e sistemit të drejtësisë (KLP, KLGJ, ILD, GJL, PP), nën kryesimin e Ministrisë së Drejtësisë, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e misionit të asistencës teknike Euralius”.

3.1 Relacioni shoqërues ka të njëjtin format si relacionet e projektakteve që propozohen nga Këshilli i Ministrave, përmbajtja e të cilit është përcaktuar me Vendimin nr. 584, datë 28.08.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar.

3.2 Format i sanksionuar në aktin nënligjor të sipërpërmendur është i detyrueshëm për aktet e propozuara nga Këshilli i Ministrave. Kjo nuk nënkupton se nuk mund të huazohet si format, sigurisht duke i’u përshtatur nismës së deputetit të Kuvendit por, kur formatit i shtohet dhe pohimi se grupi i punës është kryesuar nga një organ i pushtetit ekzekutiv, atëherë vetvetiu bie krejtësisht argumenti se ky propozim ka ardhur nga një deputet, ndërkohë që provohet e faktohet katërcipërisht se, ky proces është drejtuar pikërisht nga Këshilli i Ministrave, i cili ka ngarkuar Ministrinë e Drejtësisë për konceptimin e ndërhyrjes ligjore.

3.3 Për më tepër, relacionin shoqërues i projektligjit të iniciuar nga një deputet, përmban dhe seksionin nr. II, ku duket se deputeti ka treguar kujdes edhe për “Vlerësimin e projektaktit në raportin me Programin Politik të Këshillit të Ministrave, me Programin Analitik të Akteve dhe Dokumentet të tjera Politike”. Në këtë seksion është shprehur se: “Ky projektligj nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumentet të tjera politike”. Ky pohim në këtë dokument pjesë e praktikës parlamentare, është tregues i mënyrës se si tashmë mes qeverisë dhe Kuvendit, ka humbur çdo ndarje dhe balance në marrëdhënien e natyrës “*check and balance*” që duhet të karakterizojë veprimtarinë e tyre, dhe se ligjet draftohen nga ekzekutivi (qeveria), dhe për të shmangur konsultimin e detyrueshëm të një projektligji nga ministria propozuese.

Deputeti propozues harron që **programi analitik i akteve dhe objektivat madhorë e politikat e Këshillit të Ministrave** janë orientime dhe vendimmarrje të cilat, në rastin konkret të ndërhyrjes, nuk mundet kurrësi të jenë në të njëjtën linjë me legjislatorin (siç mbase gabimisht është harruar nga “hartuesit” ministrorë që kanë përgatitur nismën për nënshkrimin e deputetit), sepse fokusi, analiza, konceptimi, qëllimi dhe kompetencat e secilit prej këtyre organeve (Qeveria-Kuvend) është i ndryshëm.

Nëse deputeti referon dhe argumenton nisma ligjore sipas programit analitik të akteve të Këshillit të Ministrave, duke u angazhuar dhe në mënyrë proaktive përmes nënshkrimit të tij, ai duket qartë se nuk ka arritur të veçojë pozicionin e tij si ligjvënës, duke u bërë zëri i pushtetit dhe të dy bashkë (qeveria dhe ligjvënësi) cenojnë haptazi parimin e ndarjes dhe

balancimit të pushteteve, duke u kthyer për njëri-tjetrin në mjete për arritje të qëllimeve të caktuara.

Është e papranueshme sjellja e deputetëve dhe organeve vendimmarrëse të Kuvendit, kur një projektligj të hartuar nga ekzekutivi, e administrojnë duke e pranuar si fakt që është një draft i hartuar nga qeveria, por ndërkohë pa asnjë hezitim, vijojnë ta trajtojnë në praktikën parlamentare sikur të jetë një nisëm propozuese e deputetëve të Kuvendit!

Mjafton ky fakt për të provuar edhe një herë se Qeveria dhe Kuvendi i Shqipërisë janë trupëzuar në një organ të vetëm, dhe ku ky i fundit (Kuvendi) **ka humbur krejtësisht rolin e tij kontrollues e mbikëqyrës ndaj ekzekutivit.**

Kjo situatë fakton edhe një herë se Republika e Shqipërisë ndodhet në një situatë ku parlamentarizmi ka humbur rolin e tij dhe ku ndarja midis këtyre dy organeve (Qeveri-Kuvend) nuk ekziston.

Kuvendi i Shqipërisë edhe në këtë rast tregon qartë se, është kthyer realisht në një noter të qeverisë, që njehson vullnetin e kësaj të fundit dhe ku parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve i parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës, jo vetëm që nuk zbatohet midis ekzekutivit dhe parlamentit, por këto dy organe në veprimtarinë e tyre kanë humbur seriozitetin për t'u kujdesur, qoftë dhe në dukje, për respektimin e këtij parimi.

* * * * *

III. Ligji nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, objekt shqyrtimi, është miratuar në mungesë transparence dhe në mënyrë të pakonsultuar.

1. Kuvendi, në procedurën e ndjekur për miratimin e ligjit nr. 44/2021, ka shmangur procesin e konsultimit gjithëpërfshirës.

2. Kuvendi i Shqipërisë, përpara se të kalonte me procedurë urgjente këtë projektligj, duhej të ndalonte dhe të merrej seriozisht për të identifikuar realisht nevojat që kanë diktuar ndërmarrjen e kësaj nisme. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, shkojnë në të njëjtën linjë me ndryshimet e propozuara nga një tjetër deputete, në ligjin për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor dhe prekin mes të tjerash, edhe përbërjen e trupave gjyqësore. Për çështje të tilla, as iniciatori formal i kësaj nisme (deputeti propozues), dhe as kryesuesi i grupit të punës që deklarohet se ka hartuar ndryshimet (Ministria e Drejtësisë), që **janë autoritete jashtë pushtetit gjyqësor**

dhe nuk ushtrojnë pushtet qeverisës ndaj tij, nuk i kanë të gjitha mundësinë dhe kapacitetet për të identifikuar realisht të gjitha mungesat apo vështirësitë e pushtetit gjyqësor.

Nëse këto ndryshime do të vinin me kërkesë zyrtare nga organet qeverisëse të pushtetit gjyqësor, çdo deputet, apo përfaqësues i ekzekutivit, mund të legjitimohej të ndërmernte nismën konsultuese gjithëpërfshirëse, së pari, për të vlerësuar arsyet reale të paraqitjes së saj.

Asnjë propozim, qoftë ky edhe i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, nuk mund të pranohet *a priori*, pa një vlerësim të thelluar të ecurisë dhe shkaqeve të shfaqjes së problematikave.

Vetëm pas një procesi konsultimi gjithëpërfshirës, mund të arrihet në një vlerësim objektiv, të paanshëm e të thelluar për të vijuar më pas me përfshirjen në procedurën e shqyrtimit, ndryshime të mundshme të propozura.

Pikërisht, kryerja e këtij procesi vlerësimi është detyrë primare e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët në procesin legjislativ duhet të drejtëpeshojnë kërkesat për ndërhyrje legislative në krahasim me gjendjen, sjelljen në vijimësi, arritjet dhe problematikat e organit propozues dhe sistemit në tërësi.

Në rast, se Kuvendi nuk thellohet për të vlerësuar çdo propozim që i paraqitet dhe për ta konsultuar atë me gjithë aktorët apo grupet e interesit në shoqëri, por nxiton me miratimin e tyre, ekziston rreziku, që të mbulohen shkaqet reale që kanë krijuar situatën problematike, dhe rrjedhimisht edhe zgjidhja e ofruar përmes ndryshime ligjore urgjente, rrezikon të mos ofrojë qëndrueshmëri.

2. Kjo mënyrë të vepruari, kur një nismë e hartuar nga një grup pune ministror, propozohet më pas nga një deputet, shmang në mënyrë direkte edhe konsultimin e detyrueshëm të projektligjit sipas procedurave të ligjit nr. 9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, apo ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”⁴, **me veprime që praktikisht mund të konsiderohen edhe falsifikim**, duke u nënshkruar sikur janë nisma të propozuara nga një, apo disa deputetë të Kuvendit.

⁴ Ligji nr. 146/2014, përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.

Sipas nenit 6, të këtij ligji: “1. Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë: a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve; [...]”.

Ndërsa neni 7, sanksionon se: “Çdo projektakt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik.”

3. Për më tepër, në Raportin e komisionit përgjegjës citohet se:

“Projektligji u është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Shkollës së Magjistraturës, Prezencës së OSBE-së në Tiranë, EURALIUS dhe Departamentit të Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane, OPDAT.”

Atëherë, natyrshëm lind pyetja: Si mund të konsultohet një nismë me të njëjtët aktorë që kanë qënë pjesë e grupit të punës për hartimin e tij, siç është deklaruar në Relacionin shoqërues?!

Eshtë e qartë se, edhe pse *de jure* duket sikur nisma është propozuar duke shfrytëzuar nenin 81, pika 1, të Kushtetutës që të drejtën e propozimit të ligjeve ia njeher çdo deputeti, në rastin konkret nisma e nënshkruar nga një deputet (z. Alket Hyseni), *de facto*, është hartuar nga një grup pune drejtuar dhe kryesuar nga Ministria e Drejtësisë.

4. Gjithë praktika në tërësinë e saj përmban të dhëna jo koherente, kur nga njëra anë misioni Euralius deklarohet në Relacion si pjesë e Grupit të Punës, ndërsa nga ana tjetër, në Raportin e komisionit përgjegjës të datës 19.03.2021, citohet se:

“EURALIUS në përgjigjen dërguar Komisionit, shprehet se në tërësi propozimet për ndryshime konsiderohen shumë të rëndësishme për funksionimin eficient të sistemit gjyqësor shqiptar. Ndryshimet në ligjet procedurale kanë veçanërisht për qëllim reduktimin e nevojës për të zhvilluar seanca gjyqësore në Gjykatën e Lartë dhe në nivelin e gjykatave të apelit për sa i takon vendimeve procedurale, si dhe reduktimin e numrit të gjyqtarëve të nevojshëm për të marrë vendime në një gamë të gjerë çështjesh, dhe si të tilla mbartin potencialin për të ulur në mënyrë të ndjeshme ngarkesën e punës në gjykata. Ato vlerësohen në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe prandaj mbështeten nga EURALIUS.”

Këtu është momenti që Kuvendi do të duhet të thellohej për të kuptuar objektivitetin dhe profesionalizmin e qëndrimit të eksperiteve të misionit Euralius, pasi i njëjti argument dhe certifikimi i përputhshmërisë së ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile me standardet ndërkombëtare, është kryer nga i njëjti mision ekspertizë dhe me të njëjtin drejtues, në ndryshimet që janë miratuar në Kodin e Procedurës Civile, me ligjin nr. 38/2017, në kuadër të Reformës në Sistemin e Drejtësisë.

Atëherë, lind një pyetje tjetër: Pse ky standard më i mirë nuk u ofrua si opsion që në vitin 2016-2017⁵, kur u konsultuan, draftuan dhe miratuan ndryshimet në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë, por u lejua bllokimi i punës së gjykatave, përmes zgjidhjeve që çojnë në ndryshimin e ligjeve e veçanërisht Kodeve, brenda një periudhe kaq të shpejtë?

⁵ <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/28217>
<https://www.parlament.al/LibrariaAkteve/LibrariaAkteDetails/4199>

5. Presidenti i Republikës, ka ndjekur gjithashtu me shumë vëmendje edhe reagimet e shoqërisë civile, në lidhje me propozimin dhe shqyrtimin e kësaj nisme ligjore. Pas miratimit të ligjit nr. 44/2021, në seancën e datës 23 mars 2021, kanë reaguar njëzëri, menjëherë dhe bashkarisht 71 (shtatëdhjetë e një), organizata të shoqërisë civile, ku një pjesë e tyre kanë qenë pjesë aktive e konsultimit të paketës së ndryshimeve kryesore të ligjeve në kuadër të Reformës në Sistemin e Drejtësisë, në vitin 2016-2017.

Të gjitha këto organizata kanë reaguar për mënyrën absurde dhe antikushtetuese në të cilën Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar miratimin e një pakete prej 10-ligjesh, ku përfshihet dhe ligji nr. 44/2021, ligje që ndërhyjnë në themel të ligjeve të Reformës në Sistemin e Drejtësisë. Sipas asaj që është bërë publike, organizatat e shoqërisë civile që kanë reaguar janë:

1. Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT
2. Balkan Investigative Reporting Network Albania, BIRN Albania
3. Civil Rights Defenders
4. Center for Bridging Communities
5. CRCA/ECPAT Shqipëri
6. Fondacioni Down Syndrome Albania
7. Fondacioni “Mary Ward Loreto”
8. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF)
9. Fondacioni Joscelyn
10. Fondacioni “Së bashku”
11. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
12. Fondacioni Raf
13. Fondacioni “Partneritet për Zhvillim”
14. Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut
15. Gratë në Fokusin e Zhvillimit
16. Instituti i Studimeve Politike (ISP)
17. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
18. Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri
19. Instituti për Studime Ligjore dhe Publike
20. Instituti i Zhvillimit të Habitatit (Co-Plan)
21. Këshilli Shqiptar i Medias
22. Komiteti Shqiptar i Helsinkit
23. Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome
24. Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
25. Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”
26. Organizata “Gruaja tek Gruaja”
27. Organizata YMCATirana/Albania
28. Organizata “People in Focus”
29. Organizata “Well Point – Kujdes për të gjithë”
30. Organizata “Ndihmoni Jetën”
31. Organizata Mbrotjtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara – MEDPAK
32. Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
33. Platforma Kombëtare për Gratë
34. Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim

35. Qendra Europiane
36. Qendra Konsumatori Shqiptar
37. Qendra “TREJA”
38. Qendra “Community Reporters Albania”
39. Qendra për zhvillim komunitar “Sot për të ardhmen”
40. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
41. Qendra Shqiptare e Kërkimeve Ekonomike (ACER)
42. Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara
43. Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë
44. Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)
45. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
46. Qendra ALTRI
47. Qendra Rinore “Perspektiva”
48. Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”
49. Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes
50. Qendra për Shëndetin Mendor – Mental Health Albania
51. Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë
52. Qendra “Res Publica”
53. Qendra e këshillimit të grave dhe shërbimeve sociale (Kukës)
54. Roma Active Albania
55. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)
56. Rrjeti për Demokraci i Grave – WDN Albania
57. Rrjeti i Profesionistëve të Rinj
58. Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive
59. Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)
60. Shoqata Kombëtare e Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare
61. Shoqata “Në dobi të Gruas Shqiptare”
62. Shoqata “Dora Prindërore”
63. Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë”
64. Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë
65. Shoqata e Grave “Refleksione”
66. Shoqata “Voice of Roma in Albania”
67. Shoqata Lushnja
68. Shoqata “Përtej Barrierave”
69. Shoqata “Zejtarët e Veriut”
70. Shoqata “Lëvizja për Zhvillimin e Turizmit” Ksamil
71. Shoqata e Përfitimit Fizik Korçë

Këto organizata kanë mbajtur një Deklaratë të Përbashkët për Media⁶ me titull “Kuvendi miraton ndryshime të rëndësishme të reformës në drejtësi në mungesë të një procesi konsultimi dhe transparence”, duke u shprehur se:

“Shoqëria civile shpreh shqetësimin për procesin e miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë të dhjetë projektligjeve të lidhura me paketën e reformës në drejtësi. Kuvendi ka miratuar në

⁶<https://ahc.org.al/deklarate-per-media-kuvendi-miraton-ndryshime-te-rendesishme-te-reformes-ne-drejttesi-ne-mungese-te-nje-procesi-konsultimi-dhe-transparence/>

seancën e fundit plenare dhjetë projektligje në shkelje të procedurës sipas neneve 26, 27 dhe 28 të Rregullores së Kuvendit, për zhvillimin e seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve parlamentare, të cilat kryhen sipas një programi pune të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve.

Dje, me propozim të Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Kuvendi, vendosi të fusë në rendin e ditës diskutimin dhe miratimin e dhjetë projektligjeve që sjellin 154 ndryshime dhe shtesa në Kodin Penal, Kodet e Procedurës Penale dhe Civile, ligjet organike të Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorisë, ligjet për organizimin e sistemit gjyqësor dhe institucionet e reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Shoqëria civile shpreh shqetësimin se procesi i ndjekur për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre projektligjeve krijon precedent negativ, pasi bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe Rregulloren e Kuvendit.

Neni 83, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndalon zbatimin e procedurës së përshpejtuar në shqyrtimin e projektligjeve që kërkojnë shumicë të cilësuar të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Gjithashtu, e gjithë procedura e ndjekur, nga Komisioni i Ligjeve deri në miratimin e këtyre projektligjeve në seancë plenare, është kryer në mungesë të transparencës me publikun dhe konsultimit me të gjitha organet e sistemit të drejtësisë dhe shoqërinë civile, si dhe në kushte urgjence, në më pak se 30 ditë nga depozitimi në Kuvend më 25 shkurt 2021. Mungesa e një procesi konsultimi gjithëpërfshirës krijon klimë mosbesimi ndaj kësaj pakete ndryshimesh ligjore të reformës në drejtësi.

Historia e ndryshimeve të shpeshta në legjislacion, të miratuara me urgjencë, ka shfaqur jo pak probleme, sidomos në qëndrueshmërinë afatgjatë të tyre.

Shoqëria civile ka shprehur prej kohësh publikisht nevojën për një analizë të plotë dhe të kujdesshme të ecurisë së reformës në drejtësi, tashmë katër vite pas miratimit të saj. Qëllimi ynë ka qenë dhe mbetet nxitja e zhvillimit cilësor dhe të shpejtë të sistemit të drejtësisë, duke rritur efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe aksesin e qytetarëve.

Çdo nismë e ndërmarrë për këtë qëllim duhet të vijë në përputhje me standardet e duhura të proceseve ligjbërëse, në transparencë dhe konsultim të plotë, për të garantuar rritjen e besimit të publikut ndaj sistemit të drejtësisë”.

Po kështu kanë reaguar publikisht dhe aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë, si Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, që ka shprehur shqetësimet serioze për miratimin e pakonsultuar të ndryshimeve, veçanërisht sa i takon ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile dhe përbërjes së trupës gjyqësore për shqyrtimin e çështjeve të caktuara⁷.

⁷ Në një status në rrjetet sociale, DHKPGJP, është shprehur mes të tjerash se:

“Pjesa e ekzekutimit u prek nga dy ndryshime, në nenet 35 dhe 610 të Kodit ekzistues. [...] Nga 12 herë që është amenduar Kodi i Procedurës Civile, 7 herë është prekur dhe sakatuar keq pjesa e fundit e tij - Ekzekutimi. Gjithfarëloj karagozësh dhe lakenjsh të sistemit bankar kanë futur “hundë e turinj” nga viti 2008 deri në vitin 2017.

Dy - ndryshimet e djeshme që i përkasin “ekzekutimit” nuk dihet nga ç’ustallarë janë futur. Ekspertë të panjohur & të padukshëm kanë futur “propozimin” me aromë “perëndimore”. Euralius V kur u pyet, nuk dinte gjë.

Sigurisht që në këto ndryshime, nuk kanë dorë juristët më të mirë të shteti shqiptar - juristët “tallava” të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, me në krye “Mandin e Nishtullës”. Ata vetëm firmosin ç’t’u sjellin para.

Sipas dy ndryshimeve, njëri prej tyre thotë se, Gjykata e Apelit që shqyrton me një gjyqtar të vetëm ankimet kundër vendimeve për paditë me vlera minimale në shkallë vendi, tani do të shqyrtojë dhe “ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit gjyqësor”. Pra, këto lloj gjykimesh janë konsideruar të parëndësishme, minimaliste dhe do gjykohen nga një tekgjyqtar. Hajde Reforma hajde!

Mjaftojnë këto fakte, rrethana e vlerësime, që provojnë se Kuvendi i Shqipërisë ka shkelur hapur dhe në mënyrë flagrante dispozitat kushtetuese, nuk ka realizuar një proces konsultimi gjithëpërfshirës, që bëjnë të detyrueshëm kthimin e ligjit nr. 44/2021, për rishqyrtim në Kuvend, me qëllim plotësimin e të gjitha mangësive të konstatuara.

* * * * *

IV. Ligji nr. 44/2021, përmes neneve 1, 23, 31, dhe 32 deformon: standardin e deritanishëm të konsoliduar në sistemin gjyqësor, sa i takon formimit të trupave gjyqësore; parimin e sigurisë juridike; parimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit; dhe atë të realizimit të një procesi të rregull ligjor.

1. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, përmes ligjit nr. 44/2021, sanksionojnë mes të tjerash se:

“Neni 1

Në nenin 35 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. *Në paragrafin e katërt fjalια e dytë ndryshohet si më poshtë:*

“Gjykata e apelit shqyrton me një gjyqtar të vetëm ankimet kundër vendimeve për paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, ankimin e veçantë kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, si dhe rastet e tjera të parashikuara në këtë Kod.”.

2. *Në paragrafin e fundit pas fjalisë së parë shtohet fjalια:*

“Për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.”.

[...]

Neni 31

Në nenin 610 pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

“Ankimet kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor shqyrtohen nga

D.m.th. në këtë kategori minimaliste e kanë futur edhe përmbarimin dhe veprimin ekzekutues procedural. Tek “thesi” i parëndësishëm. I bie që një kundërshtim veprimi përmbarimor- si p.sh. shitje në ankand larg qoftë e 15-katëshit apo e Qendrës “Toptani” në Tiranë, do të gjykohet si ankim ndaj këtij veprimi minimalist, vetëm nga një tekgjyqtar apeli! Ndërsa ai gjyqtari - tek, i shkallës së parë do të merrret me çështjen rehat-rehat – vetëm ai, asnjë tjetër, nga fillimi në fund, sa herë palët të kërkojnë fillimin apo fundin e saj...!

Bravo eksperti i padukshëm dhe ligjvënësi me 94 duar lart. Me siguri këta tekgjyqtarët do të jenë aq të trajnuar, të besuar dhe të “vetting”-uar, sa do të gjykojnë dhe nuk do të paragjykojnë kurrë. Do të çmojnë me puritanizëm dhe superobjektivisht, kundërshtime të tilla (minimaliste) veprimesh përmbarimore.

Tashmë, Standardet evropiane janë futur kokë e këmbë në Shqipëri. Reforma në Drejtësi, i ka dhënë rezultatet e saj. Kemi supergjyqtarë nëpër sallat apo zyrat e vjetra. Një tekgjyqtar mund të gjykojë pa asnjë problem në shkallë të parë. Në apel s’kemi më nevojë për tre mendje, apo tre puritanë. Një boll është. Me një gjyqtar të vetëm tash’ e tutje mbaron punë më rehat, më lirë dhe më shpejt. Tashmë Drejtësia post pandemike do jetë më e zhdërvjellët.”

Për më shumë, statusi i plotë: <https://www.facebook.com/NCHB.AL>

i njëjti gjyqtar i vetëm gjatë gjithë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kur veprimet ose refuzimi i përmbaruesit gjyqësor lidhet me të njëjtin titull ekzekutiv, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.”.

Neni 32

Dispozitë kalimtare

1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjyqimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.

2. Rekursët e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.”

1.1 Argumentimi se propozimet janë sjellë për shkak të problematikave të evidentuara si pasojë e procesit të *vetting*-ut që ka ndikuar gjerësisht në krijimin e vakancave në sistemin e gjykatave, duke sjellë për pasojë rritjen e ngarkesës së punës dhe detyrave të gjyqtarëve, pjesë e sistemit gjyqësor, dhe se këto ndryshime lidhen kryesisht me “*eficencën, efektshmërinë dhe administrimin e sistemit të drejtësisë, duke garantuar funksionimin e sistemit gjyqësor*”, **do të duhej të merrej në konsideratë nga legjislatori në analizë të disa parimeve kushtetuese.**

1.2 Nën interpretimin e nevojës për ruajtjen e **parimit të proporcionalitetit**: Kuvendi duhet të barasvlerësojë mes,

- **të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm**, si një nga garancitë e një **procesi të rregullt ligjor** (sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj-ja), si dhe neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP-ja); ***dhe nga ana tjetër,***
- nevojës për **kolegjialitetin në marrjen e vendimeve** nëpërmjet trupave gjyqësorë, ç’ka rrit në mënyrë të dukshme profesionalizimin, garanton më shumë paanshmërinë, dhe ofron një standard më të lartë të drejtësisë. Qoftë kjo edhe për gjykimin e ankimeve të veçanta si ai kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, apo kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

1.2.1 Nëse vlerësohet njëra anë e qëllimit të ndërhyrjes, duke anashkaluar analizën mbi pasojën që mund të sjellë ky ndryshim, lind rreziku që njëri aspekt të forcohet e tjetri të cenohet. Në këto kushte, legjislatori do duhej të peshonte ndërhyrjen mbi pohimin e mësipërm në raport me gjykimin e çështjeve brenda afateve proceduriale dhe ngarkesën e punës së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, por mbi të gjitha me mundësitë dhe produktin real të punës së institucionit përgjegjës KLGj-së në përcaktimin e gjyqtarëve në gjykatat e vendit, plotësimin e vakancave të krijuara, përcaktimit të hartës së re gjyqësore, dhe për plotësimin e Gjykatës së Lartë me të gjithë trupën e saj.

1.2.2 Në fund, sistemi i drejtësisë në një kohë më të shpejtë, mbase mund të arrijë qëllimin e të zhbllokojë gjykatat nga dosjet e depozituara për t’u gjykuar, por mund të ndodhë që ky mjet (*ulja*

e numrit të gjyqtarëve në trupat gjyqësore) që synohet të implementohet përmes ligjit nr. 44/2021, të sjellë si pasojë një **cilësi më të ulët në vendimmarrjen gjyqësore** apo dhe **mosdhënien e drejtësisë**.

1.2.3 Trupa gjyqësore nuk mund të konsiderohet thjesht një numër. Trupa gjyqësore është kualifikim, dije, interpretim, konsolidim idesh dhe ndihmë në krijimin e bindjes së brendshme. Trupa gjyqësore përpara publikut dhe palëve mbart njëkohësisht detyrimin për rritje të përgjegjshmërisë së përfaqësimit të sistemit gjyqësor dhe ngritje të nivelit të argumentit.

1.2.4 Gjithashtu, sipas traditës sonë shumëvjeçare, trupa gjyqësore nga njëra shkallë e gjykimit në tjetrën është konceptuar,

- jo vetëm në **rritje të nivelit të përgatitjes së magistratit** nga ana profesionale, sepse nëse në gjykatat e shkallës së parë fakti vlerësohet drejtpërsëdrejti, në gjykim në një shkallë më të lart, diapazoni i interpretimit ligjor zgjerohet mbi aspektin abstrakt të së drejtës dhe procedurës, deri në Gjykatën e Lartë, ku unifikohen praktikat gjyqësore nëpërmjet vendimeve të kolegjeve, me arsyttime të një niveli gjithnjë e më të lartë, (çka gjen kuptim edhe në kriteret më të forta të përzgjedhjes së anëtarëve të gjykatave më të larta);

por edhe në,

- rritje të nivelit të garancisë për dhënien e drejtësisë, duke mos e lënë vlerësimin e vendimmarrjen finale të çështjes **në duart e një gjyqtari të vetëm**, apo të një trupe me përbërje më të vogël, por duke baraspeshuar faktet me kërkesat e ligjit përmes **vlerësimeve të më shumë se një gjyqtari të kualifikuar**.

Kjo siguron një gjykim të drejtë, objektiv dhe garanton më shumë palët se drejtësia do të jepet në mënyrë të pandikuar.

1.2.5 Kuvendi ka patur të gjitha mundësitë për të vlerësuar se cili është më i rëndësishëm: **produkti sasior, apo cilësia e dhënies së drejtësisë?** Këtu legjislatori duhet të kujtojë se, gjykimi duhet të vijë në ngritje të nivelit profesional, të cilën e siguron më së shumti **trupa gjyqësore e pa cenuar në numër**.

1.3 Rrjedhimisht, përveç parimit të proporcionalitetit, nëpërmjet dispozitave të ligjit është cenuar dhe parimi **i sigurisë juridike**.

1.3.1 Nenet **15** dhe **17** të Kushtetutës sanksionojnë parimin e sigurisë juridike si pjesë përbërëse dhe të rëndësishme të shtetit të së drejtës. Siguria juridike, ndër elementet thelbësore, presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara, por që në rast kufizimesh duhet të zbatojnë parimet e nenit **17 të Kushtetutës** i cili, duhet nënkuptuar si e drejtë e ligjvënësit pasi ka evidentuar nevojën reale të

ndërhyrjejes, dhe se mjete i kufizimit që është zgjedhur është domosdoshmërisht i vetmi për t'u përdorur.

1.3.2 Baza për ndërhyrjen specifike të Reformës në Drejtësi ka qenë pikërisht perceptimi dhe mungesa e besimit të publikut, mbi përgatitjen profesionale, ndikimin politik, llogaridhënien e kufizuar dhe korrupsionin e lartë. Ndryshimi i një ligji, përveç se duhet të sigurojë se, qëllimi i legjislatorit është realizuar me të vetmin mjet që kishte, **gjithashtu duhet të sigurojë se nuk ka cenuar nivelin e sigurisë juridike që kanë ofruar parashikimet e mëparshme, shtuar kësaj edhe sigurinë se këto ndryshime nuk do jenë objekt shqyrtimi sërish.**

1.3.3 Dakordësia për realizimin e ndryshimeve në këtë rast, nuk do të thotë vetëm sigurimin e numrave për të votuar një ligj me shumicë të cilësuar, por para së gjithash, duhet që këto nisma të pranohen nga shoqëria, gjë e cila mund të sigurohet përmes **konsultimit paraprak dhe një analize të plotë të çdo pasojë që mund të sjellë një rregull i ri në sistem.** Kjo analizë duhet të përmbajë përveç identifikimit të problematikave, edhe studimin e thelluar të tyre, mundësitë e zgjidhjes, ashtu dhe kohëzgjatjen e zbatimit të zgjidhjes së propozuar. **Në rast se shoqëria civile dhe një pjesë e sistemit të drejtësisë nuk kanë qenë të përfshirë në këtë proces, atëherë si mund të garantohet ligjvënësi se po bën zgjidhjen e duhur!**

1.3.4 Ndërsa në rastin konkret, ndërkohë që publiku është ende në pritje të realizimit të një pushteti gjyqësor efektiv, eficient, profesional, e të pandikuar, sepse janë në pritje të gjykimeve për dhënien e drejtësisë, **ligji objekt shqyrtimi ua cenon këtë të drejtë, duke i vendosur në pozitën regresive, sa i përket:**

- cilësisë së vendimmarrjes që mund të lidhet me cenimin e përbërjes së trupave gjyqësore;
- dyshimit për ndërhyrje dhe politizim të sistemit të drejtësisë; ashtu edhe për
- frikën se ndryshimi i tij nuk do të sjellë frytet e dëshiruara, përkundrazi mund të bjerë në kapjen më të lehtë të sistemit gjyqësor dhe rrjedhimisht në deformimin e drejtësisë së dhënë.

Veçanërisht duke patur në konsideratë parashikimet për nenet 35 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile që ndryshohen, duke parashikuar shqyrtimin e një çështjeje, apo ankimeve të veçanta për një çështjeje, nga një gjyqtar i vetëm, duke i vënë palët para dyshimit të arsyeshëm për paragjykimin që prej fillimit të çështjes prej gjyqtarit, e duke cenuar për pasojë të drejtën e palëve për ankim. Kjo sepse, një palë që ka humbur besimin te gjyqtari, në fazat vijuese të procesit përmbarrimor, duke ditur qëndrimin e gjyqtarit, do të hezitojë të ushtrojë të drejtën e ankimit.

1.3.5 Parimi i sigurisë juridike, si një koncept tashmë i interpretuar në mënyrë shteruese nga Gjykata Kushtetuese, duhet gjithnjë të prevalojë, **përveçse nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje, ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik edhe më i lartë.**

Mirëpo, ndryshimi i trupave gjyqese në shkallët e gjyqësorit, përmes reduktimit të numrit të gjyqtarëve në përbërje të tyre, rrezikon të cenojë pikërisht interesin publik për një drejtësi profesionale, efektive, të paanshme, të pakundërshtueshme për nga cilësia e vendimmarrjes.

1.3.6 Ndaj dhe ligjvënësi në këtë rast, duhet të kishte treguar shumë kujdes për këtë ndryshim, pasi është një ndryshim thelbësor në traditën tashmë të konsoliduar në mënyrën e organizimit të pushtetit gjyqësor sa i takon formimit të trupave gjyqësore.

Nga ana tjetër, pjesë e këtij vlerësimi patjetër duhej të bëhej edhe situata problematike aktuale e mbingarkesës së gjykatave, për shkak të numrit të lartë të dosjeve që presin të gjykohen, dhe numrit të pakët të gjyqtarëve në dispozicion.

Zgjidhja duhet të ishte e **mirë analizuar, studiuar dhe konsultuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, e duhet të garantonte nevojën e qytetarëve për një drejtësi të shpejtë, por dhe cilësore njëkohësisht.**

Nisur nga fakti që procesi konsultimit gjithëpërfshirës nuk është kryer, atëherë është e detyrueshme për t`u realizuar, pas kthimit për rishqyrtim të ligjit nr. 44/2021.

Ndaj për të mos ecur më tej me një nisëm që nuk rezulton të jetë e konsultuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, duhet me patjetër që Kuvendi i Shqipërisë ndryshimet e propozuara, t'i konsultojë realisht me të gjithë aktorët e interesuar, grupet e interesit, institucionet, shoqërinë civile, komunitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, këshilltarët pranë Gjykatave të Apeleve dhe Gjykatës së Lartë, institucionin e Avokatit të Popullit, OSBE, Prokurorinë e Përgjithshme, Dhomën Kombëtare të Avokatëve, Profesorët e Fakulteteve të Drejtësisë dhe Magjistraturës, etj.

Kuvendi i Shqipërisë, nisur nga kjo mundësi që jep Presidenti i Republikës përmes kthimit të ligjit për rishqyrtim, mbart detyrimin për ta realizuar këtë proces të gjerë konsultimi, përpara se të kalojë në miratimin përfundimtar të këtyre ndryshimeve kaq të rëndësishme.

Në përfundim, Presidenti i Republikës vlerëson se, të ulësh numrin e përbërjes së trupave gjyqësore, në Gjykatën e Apelit, apo në Gjykatën e Lartë, duke e justifikuar se jemi përpara një situatë të shkaktuar nga procesi i vetting, **dhe nga ana tjetër të mos marrësh masat e nevojshme dhe në kohën e duhur për të plotësuar sistemin gjyqësor me numrin e nevojshëm të gjyqtarëve, është që të pranosh hapur se po cenohet parimi i sigurisë juridike dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor.**

Është pikërisht formimi i trupave gjyqësore kolegjiale, të përbëra me një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh, që garanton dhënien e drejtësisë nga gjykatat e shkallës së parë, apo një gjykatë më e lartë.

E kundërta do të thotë të ulësh garancitë për çdo qytetar dhe pritshmëritë e tyre se do të gjykoen nga një trupë gjyqësore solide, e pavarur, që do të mund të japë realisht drejtësi.

Sa më e plotë dhe kolegjiale të jetë trupa vendimmarrëse, aq më mirë shqyrtohet një çështje, shumë herë më mirë krijohet ndërgjegja juridike dhe bindja e brendshme tek gjyqtari/rët nga diskutimi i mendimeve e këndvështrimeve të ndryshme mes tyre.

Sa më e vogël të jetë trupa gjyqësore, aq më shumë rriten mundësitë që gjyqtari të gabojë, apo të ndikohet tek ai, ç'ka ndikon direkt në uljen e cilësisë në dhënien e drejtësisë, duke krijuar një tjetër padrejtësi për palët në proces.

Ndaj, Kuvendi duhet të kishte kryer një analizë të kujdesshme dhe në konsultim me profesionistët më të mirë të sistemit gjyqësor (gjyqtarë, avokatë, ekspertë të së drejtës civile dhe proceduriale), me shoqërinë civile dhe ekspertët ndërkombëtarë të pavarur të fushës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për t'i dhënë përgjigje pyetjeve se:

- A përbën një hap pozitiv dhe të sigurtë fakti i uljes së numrit të përbërjes së trupave gjyqësore, duke prishur kështu dhe traditën shumë vjeçare në ndërtimin e trupave gjyqësore? *Dhe:*
- A do mund të gjykojë më mirë një trupë gjyqësore e përbërë nga 1 apo 3 anëtar, në krahasim me një trupë gjyqësore të përbërë nga 3 anëtarë, apo 5 anëtarë, në funksion të garantimit të dhënies së drejtësisë brenda një afati të arsyeshëm dhe ruajtjes njëkohësisht të cilësisë në dhënien e drejtësisë?

Procesi *vetting* nuk ka filluar në 2021, por në shtator 2017, dhe sipas Kushtetutës, në shkallën e parë të tij ky proces do duhet të përfundojë në shtator 2022.

Nisur nga kjo kohë që ka kaluar dhe pasojat që kanë vite që kanë ardhur, Kuvendi i kishte të gjitha mundësitë për të monitoruar dhe marrë të gjitha masat e tjera më të mira, për plotësimin e boshllëqeve në sistem, dhe jo ta linte këtë çështje kaq serioze për në fund të mandatit të tij, duke ofruar zgjidhje kaq të lehta, kaq të pasigurta, që krijojnë rrezik për të cenuar parimin e sigurisë juridike dhe standardin kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Nëse kjo është e domosdoshme në kushtet aktuale, atëherë pasi të kryhet një proces konsultimi gjithëpërfshirës, dhe nëse kjo dakordësohet nga të gjithë, këto dispozita që kanë lidhje me

formimin e trupave gjyqësore, mund të kenë regjim tranzitor, vetëm të përkohshëm, deri në përfundimin e procesit vetting dhe plotësimin e gjykatave me numrin e nevojshëm të gjyqtarëve.

Kjo mund të justifikonte zgjidhjen e gjendjes së krijuar dhe vetëm përkohësisht, pasi në të kundërt, ofrimi i kësaj zgjidhjeje jo si një urgjencë e përkohshme, por si “**sistemi më i mirë**”, jo vetëm që shtrembëron nocionin e dhënies së drejtësisë që Shqipëria ka konsoliduar deri më sot, por është dhe një sjellje aspak transparente dhe e ndershme karshi qytetarëve të këtij vendi.

2. Një ndryshim tjetër në Kodin e Procedurës Civile, përmes **ligjit nr. 44/2021**, ka pësuar dhe neni 481. Ky nen, aktualisht parashikon se:

“Shqyrtimi në kolegjet e bashkuara

Kryetari i Gjykatës së Lartë mund të vendosë që gjykata të shprehet në kolegje të bashkuara për rekurse të paraqitura nga palët, për të cilat ka praktika të ndryshme e të mëparshme në kolegjet e thjeshta.

Në këto raste kryetari i Gjykatës së Lartë cakton relatorin dhe datën e shqyrtimit të rekursit.”

Ndërsa neni 481, i riformuluar përmes nenit 23, të ligjit nr. 44/2021, synon të sanksionojë se:

“Gjykimi për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore

1. Kolegji Civil, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njëzuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Nisja e procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore mund të vendoset edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

2. Vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Civil ose i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruar për njësim ose praktikën gjyqësore të njëzuar që duhet ndryshuar. Vendimi publikohet menjëherë pas arsyetimit në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

3. Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Civil me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh, në të cilin marrin pjesë trupi gjykues që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të Kolegjit, të caktuar me short.

4. Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njëzuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

5. Data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës.

6. Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosin ndryshimin e çështjeve të shtruar për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Ky vendim i ndërmjetëm publikohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

*7. Për shkak të interesit që paraqet njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore, në këto gjykime, kur është rasti, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendimin me shkrim nga **Avokatura e Shtetit**, si dhe nga **persona juridikë publikë ose privatë**, që çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruar për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Gjykata e Lartë, në kërkesën për paraqitjen e mendimit me shkrim, cakton një afat brenda të cilit mund të paraqitet mendimi, që në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 14 ditë. Mendimet me shkrim nuk janë detyruese dhe publikohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.*

8. *Vendimi i Kolegjit Civil dhe Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.*”

Një parashikim i tillë sipas pikës 7, të dispozitës së sipërcituar, rrit rrezikun e ndikimit në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë. Ky rrezik është edhe më i shtuar në çështjet e natyrës administrative, kur parashikohet që Gjykata e Lartë të kërkojë mendim nga **Avokatura e Shtetit** dhe/apo institucione publike, kur dihet që në çështje të kësaj natyre, këto institucione, përfshirë Avokaturën e Shtetit që është në varësi direkt të Kryeministrit, të jenë palë në konflikt të hapur interesi.

Për më tepër, kur mendimi kërkohet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, ndikimi në mënyrën e trajtimit të çështjeve të caktuara në të gjithë shkallët e gjyqësorit, në favor të zgjidhjeve që mund të imponojnë organet publike, minon besimin e qytetarëve në dhënien e drejtësisë të pavarur dhe të paanshme.

Ky parashikim që ka bërë ligjvënësi, duket qartë se nuk është frut i një vlerësimi të thelluar dhe objektiv. Për të qenë i balancuar në hartimin dhe miratimin e kësaj dispozite, dhe për të garantuar sa më mirë në vendimmarrjen unifikuese si, ruajtjen e interesit të shtetit por njëkohësisht dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Kuvendi, do të duhej atëherë që në këtë dispozitë të parashikonte edhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për marrjen e mendimit me shkrim edhe prej Avokatit të Popullit, i cili sipas nenit 60 të Kushtetutës, është institucion i pavarur që mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

Ndërsa mundësia që edhe persona privatë mund të japin mendimin me shkrim për njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore, kur këta persona nuk klasifikohen si ekspertë që mund të japin mendim për çështje teknike të lidhura me një çështje objekt shqyrtimi, **e deformon rëndë rolin e Gjykatës së Lartë.**

* * * * *

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Në bindje të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 85, pika 1, dhe 93 të saj, kam vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 44/2021 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”*, pasi ky ligj është hartuar, propozuar, shqyrtuar dhe miratuar, në kundërshtim me Kushtetutën; pa një konsultim publik gjithëpërfshirës dhe pa transparencë; nuk përmbush pritshmëritë e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë për dhënien e drejtësisë cilësore; duke cenuar njëkohësisht frymën e Reformës në

Sistemin e Drejtësisë, si në raport me dispozitat në fuqi, ashtu edhe në raport me konsultimin publik që shoqëroi këtë proces kaq të rëndësishëm në vitin 2015-2016.

Përmes ligjit nr. 44/2021, Kuvendi i Shqipërisë **ka gabuar në disa dispozita të tij**, pasi nuk ka bërë zgjedhjen e duhur për të zbatuar apo konkretizuar, ashtu sikurse duhet, qasjen përkundrejt sistemit të drejtësisë për përmirësimin e funksionimit të tij.

Kuvendi i Shqipërisë, në çdo rast, duhet të kujdeset jo vetëm që normat e miratuara të mos bien ndesh me dispozitat kushtetuese, por nga ana tjetër ai mbart përgjegjësinë që ndryshimet në legjislacionin procedural apo material civil, të mos përkeqësojnë situatën e trajtimit ligjor të qytetarëve, por ta përmirësojnë atë, duke përmirësuar njëkohësisht çdo hallkë të tre pushteteve, përmes një procesi legjislativ sa më cilësor.

Ndërkohë që vlerësimi paraprak i përputhshmërisë me Kushtetutën të një ligji është detyrë primare e institucioneve kryesore të shtetit, ku Kuvendi ka përgjegjësinë e drejtpërdrejtë, Presidenti i Republikës, si Kryetari i Shtetit ka përgjegjësinë kushtetuese të ndërhyjë përmes mekanizmit të kthimit të ligjit, jo vetëm në ato raste kur konstaton antikushtetutshmërinë e ligjit apo procedurës së ndjekur për miratimin e tij, por të vlerësojë edhe nëse modeli i zgjedhur nga ligjvënësi përmes ndryshimeve në ligj, është ose jo më i miri, në funksion të interesit të të gjithë qytetarëve të vendit.

Për arsyet e parastruara më sipër, Kuvendi duhet të shqyrtojë edhe një herë përmbajtjen e ligjit **nr. 44/2021**, me qëllim që ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, jo vetëm të hartohen, por edhe të propozohen në respektim të dispozitave kushtetuese, në përputhje me frymën gjithëpërfshirëse të realizimit të Reformës në Drejtësi dhe në interes real të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Sinqerisht,

Illir Meta